



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË

BURSA STUDIMI NË FRANCË, VITI AKADEMIK 2019-2020

Në kuadrin e Bashkëpunimit Kulturor, Qeveria e Republikës së Francës për vitin akademik 2019-2020 ofron bursa pasuniversitare në programe studimi: **Master** dhe **Doktoratë** (tezë në cotutelle) për shtetasit shqiptarë, të cilët dëshirojnë të studiojnë në universitetet publike franceze, për sa në vijim:

- **Bursa studimi Master**, deri në 10 muaj (shtator 2019 - qershor 2020). Bursa mujore mbulon shpenzimet e ushqimit, asistencë për akomodim, tarifën e regjistrimit dhe të shkollimit në institucionet publike të arsimit të lartë dhe siguracionin shoqëror. Shpenzimet e udhëtimit do të mbulohen nga vetë kandidatët.
- **Bursa studimi PhD** për periudhën shtator 2019 - gusht 2022. Bursa në “*co-tutelle*” përfshin **15 muaj mobiliteti** të shpërndara në 3 vite të njëpasnjëshme akademike. Bursa përfshin pagesën mujore si dhe siguracionin shoqëror. Bursa nuk mbulon shpenzimet e transportit ndërkombëtar. Shpenzimet e udhëtimit do të mbulohen nga vetë kandidatët.

Kandidatët mund të aplikojnë për programe të ndryshme studimi. Megjithatë, prioritet do të kenë fushat e studimit: klima, biodiversiteti, mjekësia, energjia, migracioni.

Krahas aplikimit *online*, kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentacionin e plotë pranë zyrave të shërbimit, të bashkëpunimit dhe veprimtarive kulturore të Ambasadës Franceze në Tiranë. Ambasada Franceze në Tiranë nënvizon se **çdo dosje e paplotë ose jashtë kriterëve nuk do të pranohet për shqyrtim.**

Dosjet shqyrtohen nga Juria përgjegjëse e ngritur pranë Zyrës së Shërbimit për Bashkëpunim dhe Veprimtari Kulturore. Juria është e pavarur dhe vendimi i saj është përfundimtar. Për kandidatët, dosjet e të cilëve do të përzgjidhen paraprakisht, do të ketë edhe një intervistë pranë zyrës përkatese të kësaj ambasade.

Afati i fundit për dorëzimin e dokumenteve në Ambasadën Franceze në Tiranë është data **31 maj 2019** në adresën e mëposhtme:

Ambasada e Francës

Shërbimi për Bashkëpunim dhe Veprimtari Kulturore

Rruga Skënderbej Nr. 14,

Tiranë

Kandidatët fitues për bursat e studimit te ofruara nga qeveria franceze do të shpallen gjatë muajit korrik 2019.

Gjithashtu, për një informacion më të detajuar për mënyrën e aplikimit dhe të përgatitjes së dokumentacionit, ju lutemi referojuni materialeve bashkëlidhur dhe adresave në web-site:

<https://al.ambafrance.org/Bourses-du-Gouvernement-Francais-pour-les-Master-2-et-Doctorat-2018-2019;>

<https://al.ambafrance.org/Bursa-te-qeverise-franceze-per-Mastera-dhe-Doktoratura;>

Email: kleopatra.koleka@diplomatie.gouv.fr

Email: valbona.nano@diplomatie.gouv.fr

DREJTORIA E INTEGRIMIT, KOORDINIMIT, MARRËVESHJEVE DHE ASISTENCËS